

---

# RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

---

## **Linje per prodhimin e tubacioneve te betonit.**

---

Shkurt , 2015

---



ECO – PROJECT ALBANIA  
Environmental Consulting

## 1. HYRJE

Vendi yne eshte anetare e nje numri konventash nderkombetare, si rrjedhoje eshte i detyruar te zbatoj nje sistem sa me efektiv ne fushat ekonomik-social-mjedisor, per rregullimin e territorit sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore. Mjedisi eshte burimi i gjithckaje per te cilen njerezit kane nevoje per te jetuar dhe per tu zhvilluar. Sa me i degraduar te jete mjedisi aq me keq ndikon ne shendetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik-social. Prandaj duhet nje menaxhim sa me mire i mjedisit natyror ne lidhje me aktivitetin njerezor qe po zhvidhohet cdo dite e me shume. Ne Shqiperi, zhvillimi i veprimtarise ekonomike dhe tranzicioni i veshtire drejt ekonomise se tregut ka ushtruar trysni te forte ne mjedis duke ndikuar negativisht ne te. Investimet e reja kane sjelle ndikime ne mjedis, por tashme eshte arritur qe shume prej veprimtarive qe ushtrojne aktivitet brenda territorit te Republikes se Shqiperise, ti nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis perpara miratimit dhe zbatimit te tyre si qellim per te parandaluar krijimin e zonave te tjera te ndotura, ky qellim eshte kaq i rendesishem saqe theksojme qe parandalimi eshte edhe me i mire edhe me pak i kushtueshem sesa kurimi, (parimi i parandalimit).

Objektivi kryesor i VNM-se eshte te identifikojte ndikimet e mundshme negative mjedisore te projekteve te reja te zhvillimit.

Permes porositesit te subjektit "ARJEIL" Sh.p.k. studio mjedisore ECO PROJECT ALBANIA ka marre persiper hartimin e raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis .Ky aktivitet ndodhet ne Fshatin Dritas, Komuna Zall Herr, Tirane

## 1.KUADRI LIGJORE DHE INSTITUCIONAL KOMBETARE

### 1.1.1 Qellimi I VNM-se

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimtarie apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Por sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM-se. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM-se per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Hartimi i ketij raporti VNM eshte bere ne perputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " ku sipas nenit 9 te ketij ligji ,percaktohen edhe projektet qe I nenshtrohen procedures se vleresimit paraprak te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ,sipas shtojces II (pika 10) Germa a)

### 1.1.2 Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar e konsiderueshme potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM-se:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit

- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit te propozuar

Objektivat afatgjata te VNM-se:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve
- Permireson aspektet sociale te projektit

### 1.1.3 Kuadri Ligjor

Gjate dhjetevjeçarit te fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore te cilat kane ardhur si rezultat i industrise para viteve 90-te dhe zhvillimeve te fundit ne fushen e ndertimit dhe industrise.

Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) shkruhet se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe ne plotesimin e nismes dhe te pergjegjesise private, synon:

Neni d): nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem.

Sipas Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Ministria e Mjedisit eshte autoriteti pergjegjes per rishikimin e dokumentit VNM te pergatitur nga ekspertet e licensuar prej ministrise se mjedisit.

Pervec Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Parlamenti i Republikes se Shqiperise miratori edhe Ligjin Nr. 10440 Date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”. Ky ligj eshte zhvilluar dhe bazuar ne Direktivat e EU dhe praktikat nderkombetare te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me VNM-ne dhe mjedisin përfshijnë

1. Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 ‘Për mbrojtjen e mjedisit’, të ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 ‘Për vlerësimin e ndikimit në mjedis’, të ndryshuar; Neni 8 shtojca II e ketij ligji aktiviteti ne vleresin kategorizohet ne Piken 10 Prodhime Infrastrukturore Germa a)Projekte per zhvillimin e pasurive te patundshme industrial.

- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" ndryshuar me ligjin, Nr.9868, datë 4.2.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906 datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura"
3. Ligji nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar.
  4. Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"
  5. VKM nr. 686, datë 29.07.2015 'Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore';
  6. VKM nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"
  7. Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;
  8. VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"
  9. VKM nr.175, datë 19.1.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
  10. VKM nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme"
  11. VKM nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
  12. VKM nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"
  13. VKM nr.519, datë 30.6.2010 "Parqet Natyror Rajonal"
  14. VKM nr.897. datë 21.2.2011 "Miratimi i Rregullave për Shpalljen e Zonave të Vecanta të Ruajtjes"
  15. VKM nr. 221, datë 20,2,2013 "Caktimi i Zonave si Brezi i Gjelber i Tiranës"
  16. VKM nr. 532, datë 05.10.2000 "Për miratimin e studimit "Strategjia dhe Plani i veprimit për biodiversitetin"
  17. VKM nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare"
  18. VKM nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"
  19. Vendimi Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
  20. VKM nr 352, datë 29.04.2015. "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të".

## 2.PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

### 2.1.1 Te pergjithshme

Shoqeria "ARJEIL" sh.p.k. me Administrator Z. Arjan Latifi do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e ndertimit ne prodhimin e tubave te betonit me seksione dhe dimensione te ndryshme . Eshte nje nder kompanite e para ne vend do te perdore impiante teknologjike te perparuar per prodhimin e tubave te betonit dhe fokusimin ne cilesi per produktet e veta. Prodhimi do te behet sipas normes europiane EN 1916. Shoqeria Arjeil eshte e pajisur dhe me certifikata ISO 9001:2008 per sistemin e menaxhimit me qellimin e Prodhim dhe shtitje te tubave te betonit, kesone betoni, puseta betoni, bordura beton. Shoqeria "ARJEIL" SHPK eshte e pajisur me keto leje:

- Leje Mjedisore Tipi C Magazinim, ngarkimi ose shkarkimi ne mase te madhe I cimentos ose I klinkerit te cimentos perpara transportit te tyre ne mase te madhe.

-Leje Zhvillimore Ndertimi Nr prot 1013 date 30.03.2015

- Leje Ndertimi me Vendim K.RR.T-se Nr 1,date16.09.2012 me afat kohore deri me 27.02.2015

-Leje perdorimi Nr prot 3171 date 01.12.2014

Per te realizur Vleresim te Ndikimit ne Mjedis investitori ka nenkontraktuar studion mjedisore ECO PROJECT ALBANIA.

### 2.1.2 Qellimi I aktivitetit

Qellimi I aktivitetit ne vleresim do te konsistoje ne procesin e prodhimit te tubave prej betoni me seksione dhe dimensione te ndryshme te cilat jane nje element shume I rendesishem ne industrine e ndertimit

### 2.1.3 Objektivat e aktivitetit

Objektivi I pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Shkarkimet ne ujera nga procesi teknologjik
- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune

- Mbetjet e gjeneruara nga procesi teknologjik
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones


Objektivi I dyte I ketij aktiviteti eshte do te jete gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

#### 2.1.4 Informacion mbi vendndodhjen e aktivitetit

Zona ne te cilen ndodhet aktiviteti ne studim eshte ne Fshatin Dritas, Komuna Zall-Herr. Objekti eshte ndertuar ne funksion te ketij aktivitet me miratimin e institucioneve perkatese me ane te Lejes Ndertimore . Treguesit e zhvillimit te struktures jane:

Siperfaqja totale e parceles eshte	6200 m <sup>2</sup>
Siperfaqja totale e ndertimit eshte	493 m <sup>2</sup>
Intensiteti I ndertimit eshte	0.08
Lartesia e struktures	7.5 m
Koeficienti I Shfrytezimit te tokes per ndertim	8 %

Subjekti eshte I pajisur me certificate pronesie ne zonen kadastrale nr 1549 me numer pasurie 517/2, 517/53, 517/54



*Fig.1 Vendodhja e objektit ne lidhje me rajonin dhe zonen*

Tabele nr. 1: Koordinatat e vendodhje se aktivitetit

Pika	X	Y
1	4395659.64	4586879.64
2	4395726.44	4586907.29
3	4395688.65	4586962.36
4	4395636.90	4586951.83

### 2.1.5 Subjekti kerkues

Subjekti “ARJEIL ” Sh.p.k, eshte nje subjekt privat i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR) me Numer Identifikimi (NIPT): K31320002C me Data e Regjistrimit 20/01/2003 me perfaqesues ligjor Z.ARJAN LATIFI

### 2.1.6 Pershkrimi I proceseve teknologjike te tubave prej betoni

Shoqeria “ARJEIL”Sh.p.k ne kuader te aktivitetit te saj ndertimor dhe duke pasur parasysh kerkesat e tregut dhe rritjen e cilesise se produkteve e pa te arsyeshme te insvestoje ne nje impianti prodhimi te tubave te betonit duke investuar ne blerjen e nje makinerie per prodhimin e tubave me cilesi te larte. Kapaciteti maksimal ditor qe investitori mendon te prodhoje eshte 50 m<sup>3</sup> ne perputhje plotesisht me synimin e kompanise qe t’i afrohet tregut te perdorimit te materialeve te ndertimit, si materiale te gatshme per sektorin e ndertimit. Gjithashtu sheshi eshte larg qendrave te banuara . Impianti eshte projektuar sipas normave Europiane per mbrojtjen e mjedisit si ne lidhje me ndotjen nga gazrat dhe pluhurat qe shkarkon ashtu edhe me ndotjen akustike. Shoqeria do te aplikoj nje teknologji per prodhimin e materialeve te ndertimit, e cila karakterizohet per thjeshtesine e saj dhe siguron ruajtjen e mjedisit ne te gjitha aspektet. Keto impiante jane projektuar per te patur ndotje te ujit apo ajrit sa me te pakta, dhe lenda e pare materiale inerte, cemento, granili , rera shfrytezohen plotesisht duke mos krijuar mbetje teknologjike.






Fig.2 Skema e procesit teknologjik te prodhimit te tubave te betonit

Per kryerjen e ketij aktiviteti shoqeria do te punesoje specialiste prodhimi betonesh dhe perdoruesit e makinerive te jene njohes te mire te kesaj teknologjie. Teknologjia qe do te

perdoret per prodhimin e tubave te betoneve eshte e markes "COLLE" Tipi "Vibrotubi 30/360" e cila prodhon tuba me seksion rrethor me diameter DN300mm deri DN3600mm (tuba me seksion drejtkendesh) me dimensione deri 3000x5000mm.

**Lendet e para jane:**

- Cimento
- Granil
- Rere

**Lendet ndihmese mund te konsiderohen:**

- Uji
- Energjia Elektrike

**Objekti Linje prodhimi per tuba betoni pare si kompleks ndertimesh, perbehet nga:**

- Kapanoni i mbuluar
- Bunkeret e materialeve inerte
- Peshore e materialeve
- Transportieri kryesor
- Peshore çimentoje
- Shneket e çimentos
- Peshore uji
- Peshore aditivi
- Mikseri perzjeres
- Mbulesa
- Kabina elektrike
- Komandimi automatik
- Makinerite e prodhimit
- Kompresor 300 litra
- Kabllo
- Etj.

**Pervec objekteve te mesiperme linja e prodhimit te shtyllave te betonit ka ne dispozicion edhe keto objekte:**

- Parku i mjeteve.
- Zona per depozitimn e materialeve inerte mali dhe lumi
- Ndertesa administrative
- Vendparkimi per administraten dhe punonjesit
- Kapanonet e Prodhimit

- Mjedise per depozitimin e produkteve
- Sheshi i lire
- Etj.
- Zyrrat
- Kapanonet e prodhimit
- Nyjet sanitare
- Magazinat

### **Pershkrimi I linjes se prodhimit dhe proceset qe ndodhen ne te**

Teknologjia e perdorur eshte moderne dhe bashkekohore per prodhimin e tubave te betonit dhe tregetin e tyre, si dhe per magazinimin e lendes se pare.

Lenda e pare per prodhim jane inertet e malit dhe lumi dhe uji qe vijne nga vete shoqeria e me te trete me kontrate, si dhe çimento qe vjen nga burime te brendeshme dhe te jashtme.

### **Pershkrimi i procesit teknologjik te prodhimit betonit**

Impianti I prodhimit te betonit eshte prodhim Italian dhe eshte I perbere nga:

- Bunkeret e inerteve
- Peshorja e inerteve
- Kova e transportit te inerteve per ne mikser
- Mikseri
- Sillozi I cimentos
- Shneku I cimentos
- Peshorja e cimentos
- Depozita e ujit
- Depozita e aditivit,
- Peshorja e ujit
- Paneli I komandimit.

Materjali I depozituar ne nje piste e cila eshte shtruar me beton hidhet ne bunkeret e inerteve me mjetet fadrome me 4 (kater) dimensione rere0-2mm,rere2-6mm, granil 6-10mm, granil 10-26mm.

Procesi teknologjik vazhdon me peshimin e materialit inert per realizimin e markave te ndryshme te betonit. Ne te njejte kohe qe peshohen materjalet inerte ne peshoren tjetër peshohet çimento e cila merret nga sillozi me ane te shnekut te cimentos. Cimentoja vjen nga pika e furnizimit me bot dhe shkarkohet ne Silloz. Linja ka nje silloz me kapacitet 60 ton. Sillozi eshte I mbyllur ne menyre hermetike. Furnizimi behet me tuba gome me diameter 150 mm. Ne linje eshte instaluar filtri I pluhrave te çimentos ne menyre qe pluhuri te mos dale ne atmosfere.

Pasi peshohen te gjitha lendet e para inerte, cemento dhe uje behet hedhja e tyre ne mikser. Inertet jane shkarkuar ne koven e mikserit e cila leviz ne drejtim te mikserit dhe shkarkohet ne te. Kova ka kapacitet 1 m<sup>3</sup>. Sapo inertet jane shkarkuar atehere behet edhe shkarkimi i cimentos dhe ujit nga peshoret perkatese te cilat ndodhen mbi mikser.

Nderkohe qe ne momentin e shkarkimit te inerteve ne mikser ka filluar procesi i perzjerjes se betonit. I gjithe procesi i prodhimit te betonit eshte automatik dhe komandohet nga paneli i komandimit. Impianti i prodhimit te betonit ka nje kapacitet prej 70 m<sup>3</sup> ne dite.

Pasi betoni ka mbaruar procesin e perzjerjes behet shkarkimi i tij nga mikseri per ne rripin e transportierit qe e con tek bunkeri i makinerise se prodhimit. Prosesi teknologjik i prodhimit te betonit per tubat e betonit eshte mjaft i thjeshte. Ai konsiston ne punen e pajisjeve per dozim dhe perzjerje te perberesve te betonit.

### **Procesi i prodhimit te tubave te betonit**

Tubat e betonit prodhohen nga makineria COLLE VIBROTUBI 30/360 e cila eshte prodhim Italian i viteve te fundit. Makineria ndodhet Brenda kapanonit me dimensione 50 m x 20 m me kartesi te brendshme prej 7.5m. Ne kapanon eshte instaluar edhe nje vinc ure me kapacitet 20 ton qe leviz ne shina ne traret e kapanonit. Perpara se te filloje prodhimi ne makineri kontrollohen te gjitha pjeset perberese te saj qe jane, bunkeri i betonit dhe rripi i ushqyerjes qe ben furnizimin e makinerise me beton. Kallepi i brendshem i tubave ne te cilin eshte montuar edhe vibratori qe realizon vibrimin dhe ngjeshjen e betonit. Vibratorit i vendosen xhirot e nevojshme per llojin/diametrin e tubit qe do te prodhojme. Kallepi duhet te jete i kapur fort pas bankos se makinerise. Per kete arsye kontrollohen te gjithe bullonat me te cilet fiksohet ne banko. Me pare e kemi levizur bankon dhe e kemi fiksuar ne varesi te gjatesise qe do te prodhojme tubin. Gjatesia varion nga 1 deri 3 ml. Kontrollohet edhe karreli i levizshem qe ben shtypjen ne perfundim te prodhimit me ane te preses hidraulike. Me pas kontrollohet kallepi i jashtem i tubit i cili duhet te jete i paster dhe duhet ti funksionojne te gjitha pajisjet kapese dhe fiksuese. Pasi eshte montuar edhe kallepi i jashtem makineria eshte gati per prodhim. Prosesi i prodhimit eshte automatik dhe kontrollohet nga paneli i komandimit. Me pare kemi zgjedhur ne panel kohet dhe te dhenat e nevojshme per secilin proces te prodhimit te tubit. Pasi kemi dhene komanden e fillimit te punes makineria fillon mbushjen e kallepeve me ane te rripit ushqyes. Rripi ben mbushjen e kallepit du bere levizje rrethore sipas diametrin te tubit. Ne te njejten kohe behet edhe procesi i vibrimit te betonit ne kallep me ane te vibratorit te instaluar. Brenda formes se brendshme te tubit. Kur ka mbaruar mbushja me beton e kallepit rripi i ushqimit largohet dhe ne kete kohe afrohet karreli i cili leviz mbi dy shina. Ai shkon dhe fiksohet mbi kallepet e tubit dhe ben shtypjen e betonit duke realizuar koken e tubit. Kjo realizohet me ane te shtypjes se preses hidraulike. Pasi ka bere kete karreli largohet dhe shkon ne pozicioni fillestar. Tani produkti eshte gati per tu hequr nga makineria. Afrojme vincin mbi product dhe me ane te pajisjeve kapese e kapim produktin bashke me kallepin e jashtem te tij dhe e ngrejme duke e

hequr nga makineria. Me pas e transportojme me vincin ure ne fund te kapanonit dhe bejme demontimin e forms se jashtme. Lirojme kapeset e kallepit te cilat e mbajne te lidhur me paleten e poshtme te tubit dhe e ngrejme lart me vinc. Ne kete menyre behet demontimi I kallepit I cili pasi pastrohet shkon perseri me vinc ne makineri per te prodhuar tubin e rradhes. Pas prodhimit tubat lihen 24 ore ne kapanon dhe me pas I transportojme ne vendin e depozitimit te tyre. Pasi kane kaluar kohen e nevojshme per stazhonim tubat I vendosim ne vendin e magazinimit ne stiva sipas dimensioneve dhe karakteristikave teknike te tyre. Pasi jane stazhionuar tubat jane gati per transport ne veprat per te cilat jane porositur. Transporti behet me ane te mjeteve te posacme te pajisura me vinc te cilat jane pronesi te Shoqerise. Per te realizuar kapacitetin ditore te prodhimit behet miksimi I lendeve te para me raportet si me poshte:

- Cimento 25 ton
- Granil 45m<sup>3</sup>
- Rere 40 m<sup>3</sup>
- Uje 7000 litra

### 2.1.7 Mbetjet e lengeta

Mbetje te lengeta mund ti kemi vetem ne keto momente:

- Ne rastin e shiut te pare qe shplan sheshin e punes dhe merr me vete ndotjen siperfaqesore nese ka

Gjate procesit teknologjik nuk gjenerohen mbetje te lengeta, ujerat qe dalin gjate aktivitetit te shoqerise Arjeil shpk mund te permbajne mbetje te ngurta te inerteve, cimento dhe sasi te vogla hidrokarburesh ne raste aksidentesh. Shoqeria e ka sistemuar siperfaqen e shesheve me nivel qe ujrat te mblidhen ne piken me te ulet dhe me pas te derdhen ne Lumin Terkuze qe gjenden shume prane subjektit.

### 2.1.8 Mbetjet e ngurta

Mbetjet e ngurta qe gjenerohen nga aktiviteti i shoqerise Arjeil shpk jane copeza inertesh qe dalin nga procesi teknologjik. Mbetje te tjera jane mbetje urbane si letra karton shishe plastike ose kanace etj. Keto mbetje inerte do te grumbullohen ne ambientet e subjektit dhe kryesisht do te perdoren per te mbushur rrugen qe lidh rrugen kryesore me subjektin ose siperfaqe te tjera qe kane nevojte per mbushje.

### 2.1.9 Fuqia punetore

Numri i personave qe do te punesohen ne kete projekt do te jene 10-15 persona nga zonat perreth. Funksionet do te jene administrate, mirembajtje, punetore, prodhimi, roje etj. Punonjesit do te

punojne 8 ore ne dite dhe 6 dite ne jave. Stafi do ti nenshtrohet trajnimeve per sigurine ne pune dhe ceshtjeve mjedisore.

### **2.2.1 Lendet e para (uje, energji, karburant)**

I gjithë objekti ka një projekt të vecantë elektrik në të cilin përfshihet instalimet elektrike me linja kabllorë të furnizimit për ndricim në të gjitha ambientet e këtij ambienti. Subjekti përdorë linjen elektrike të zonës sipas një kontrate që kanë midis paleve. Sistemi i furnizimit me ujë është ndërtuar nga vetë shoqëria nëpërmjet sistemit të shpimit të instaluar brenda territorit të objektit dhe që nuk ndikon në furnizimin me ujë të banorëve të zonës. Për sa i përket gjeneratorit ai ka një kapacitet prej 100 KVA dhe parashikohet të punojnë 50-100 orë/vit, sasia e dieselit të konsumuar për një vit parashikohet të jetë 400-600 litra

### **2.2.2 Skema e tokezimeve dhe e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.**

Subjekti ka një sistem tokezimi të realizuar sipas një projekti tip, për të mbrojtur makineritë të cilat punojnë me energji elektrike nga ndonjë shkarkim atmosferik dhe punonjësit e firmës. Megjithatë sygjerojmë që subjekti të marrë masa për të verifikuar për funksionim një herë në vit të gjithë sistemin e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike pasi është me mjaft rëndësi.

### **2.2.3 Masat kundër zjarrit dhe sigurisë në punë**

Zbatimi i këtij projekti nuk do të sjellë rrezikshmeri për aksidente, duke qenë se nuk do të ketë mbajtje ose përdorim i substancave të rrezikshme. Në rast se do të kemi derdhje të lendeve si nga automjetet e transportit do të merren masa për largimin e saj nga mjedisi si dhe do të vendosen tabela sinjalizuese për të shmangur aksidente rrugore gjatë hyrjes dhe gjatë daljes si nga vendi i ushtrimit të aktivitetit. Rrjeti elektrik i zonës do të jetë i ri, gjatë zbatimit të projektit për këtë rrjet është pasur parasysh që të realizohet tokezimet e nevojshme për të gjitha makineritë dhe pajisjet e nevojshme. Punonjësit do të sensibilizohen dhe do të detyrohen të respektojnë me përpikëmeri të gjitha rregullat për sigurimin teknik. Subjekti do të marrë masa për rrezikun nga zjarri duke vendosur fikese në të gjithë territorin dhe do të realizojë trajnimin e stafit për të përballuar situatat e emergjencave. Gjatë punës duhet të përdoren doreza, veshje pune, çizme. Në vendet e punës duhet të afishohen edhe rregulloret e sigurisë në punë për secin sektor. Ndalohet kategorikisht prania e njerëzve që nuk kanë punë në sektor. Në rast se ndodhin avari të ndryshme punonjësi vepron me gjakftohtësi dhe shpejtësi për të bllokuar dhe kufizuar ngjarjen e ndodhur duke zbatuar rregullat e punës, kur nuk e përballon vetëm kërkon ndihmën e punonjësve të tjerë. Në rast aksidentimi përdorë kutinë e ndihmës së shpejtë mjekësore. Për ndodhitë i raportohet shefit të sektorit.

#### **2.2.4 Mirembajtja e vendit te punes**

Pasi mbaron procesi i punës duhet te behet pastrimi i pajisjeve, formave sipas përmasve, veglave, shesheve te punës etj. Largohen te gjitha mbetjet e lendeve te para te cilat çohen ne piken e grumbullimit te mbetjeve te fabrikës. Pastrohen te gjitha mjetet e punës. Lahet dhe fshihet dyshemeja e sektorit, ajroset mjedisi dhe vihet çdo mjet pune ne gatishmëri pune për ditën pasardhese. Do te behen shërbimet teknike për makineritë dhe pajisjet ne rast se kërkohen nga instruksionet e tyre. Stakohet kuadri elektrik dhe i raportohet shefit te sektorit për gjendjen e rregullt te vendit te punës.

## 3. PERSHKRIMI I MJEDISIT

### 3.1 Pershkrim i mjedisit socio-ekonomik

#### 3.1.1 Popullsia

Zona ku do të zhvillohet aktiviteti është një zonë me pak banim. Ajo i përket komunes së Zall Heerit të rrethit të Tiranës. Kjo zonë ka patur karakter agrar në vitet e regjimit komunist dhe në vitet 90 e në vazhdim filloj të marrë karakter industrial dhe tregtar. Tashmë kjo zonë është zhvilluar nga pikpamja tregtare dhe pjesërisht në anën industriale. Qendrat e banuara janë fshati Dritas (distance 790m), Cerkez Marine (distance 2552m), Qereke (distance 1496m), Valias (distance 1978m), Rinas (distance 4151 m),Kamez(distance 3200 m).




Fig.3 Zonat e banuara në afërsit të zonës së projektit



Pas viteve 1990 Shqipëria ka kryer disa hapa të rëndësishëm përsa i përket decentralizimit, si në kontekstin politik ashtu edhe në atë administrativ, dhe cilësohet si një ndër reformat e para më të rëndësishme të Shtetit të Ri demokratik. Pas decentralizimit politik, që mund të thuhet se është përmbyllur me sukses, periudha e dytë përkon me decentralizimin fiskal. Një ndër nismat më kryesore të kësaj periudhe është dhe ligji 8652 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, i cili e përcaktoi planifikimin urban, së bashku me kontrollin e zhvillimit, si funksion të vetë bashkive dhe komunave.

Si rrjedhojë e kësaj periudhe, Shqipëria tashmë ka administrohet nga 369 komuna dhe bashki, Nj.Q.V të nivelit të parë dhe nga 12 qarqe nj.q.v të nivelit të dytë. Por është vënë re se shumë prej komunave dhe bashkive, si rrjedhojë edhe e lëvizjes së popullsisë drejt qendrave kryesore urbane, tashmë nuk arrijnë të krijojnë ekonominë e shkallës për të mbledhur financat e nevojshme për mirë-qeverisjen e territorit të tyre. E shoqëruar kjo me rolin e paqartë të qarkut ka sjellë në një situatë kaotike të zhvillimit të territorit dhe në një zhvillim mono-centrik të territorit të Shqipërisë.

Një ndër reformat më të rëndësishme të qeverisë lidhet ngushte me çështjen e qeverisjes së territori dhe më konkretisht me një reformë eficiente të administrimit të territorit. Është e nevojshme, që përtej decentralizimit, tashmë të shtohet dhe procesi i “de-koncentrimit” ose i rajonalizimit. Pra, një pjesë e detyrave dhe fuqive të qeverisjes vendore por edhe qendrore tashmë duhet të kalojnë në një nivel të ndërmjetëm i cili do të kryejë dhe harmonizimin midis dy niveleve të ndryshme.


Pa dyshim edhe sektori i planifikimit të territorit preket nga kjo reformë jo vetëm përsa i përket anës administrative por edhe konceptimit dhe përqasjes në territor që duhet të kenë planet rajonale. Nga vetë natyra planifikimi në nivel kombëtar ka më shumë karakteristika të një kuadri politikash për zhvillimin e territorit, ndërkohë që ai vendor fokusohet më shumë në përdorimin e tokës. Shtresa e re e planifikimit rajonal do të ketë një përqasje më strategjike në territor, duke u munduar që politikat kombëtare të zërthehen në dokumente strategjike dhe duke ofruar në këtë mënyrë instrumentin e munguar i cili do të kryejë harmonizimin e dy niveleve.

Rajonalizimi përtej aspektit qeverisës është i rëndësishëm për dy arsye kryesore si rritjen e konkurrencës së rajoneve shqiptare midis njëra-tjetrës dhe në arenën ndërkombëtare si dhe për të rritur kohezionin territorial në Shqipëri. Nisur edhe nga objektivat kryesore të politikave Europiane, si Perspektiva Europiane për Zhvillimin Hapësinor, Strategjia e Europës 2020 apo dhe vizionet e hedhura nga ESPON (2006 dhe 2014) roli i rajonit është shumë i rëndësishëm për arritjen e kohezionit dhe konkurrencës. Pra, thelbi është që duke konkurruar me njëra tjetrën rajonet mund të rrisin të ardhurat e tyre, të rrisin kohezionin

territorial. Për këtë arsye Shqipëria të fillojë të lëvizë drejt një sistemi policentrik territorial në ndryshim nga trendi ekzistues.

Popullsia e Shqipërisë më 1 Janar 2015 arriti në 2.893.005 banorë duke pësuar një rënie prej 2.942 banorësh, krahasuar me atë të 1 Janarit 2014. Nga kjo popullsi, 1.462.005 janë meshkuj dhe 1.431.000 janë femra. Raporti gjinor i popullsisë së Shqipërisë është 102,1 meshkuj për çdo 100 femra. Mosha medianë e popullsisë së Shqipërisë në 1 Janar 2015 është 35 vjeç.

Qarku me popullsinë më të lartë në Shqipëri mbetet Tirana me 800.986 banorë. Nga të gjitha qarqet vetëm Tirana dhe Durrësi Vloa kanë njohur rritje të popullsisë, ndërsa popullsia e të gjitha qarqet e tjera te vendit ka pësuar rënie. Qarku me rritjen më të madhe të popullsisë është Tirana me një rritje vjetore prej 1,61 %.



**Grafiku nr. 1: Popullsia e Shqipërisë 2001 - 2015**

**Tabela nr.2: Popullsia ne baze qarqesh**

1 Janar 2014			1 Janar 2015			
Qarku	MF	M	F	MF	M	F
Tirane	788.330	392.273	396.057	800.986	399.157	401.829

### 3.1.2 Aktivitete kryesore te zones

Pozita gjeografike ne qender te shqiperise dhe ne afersi te dy qendrave me te medha urbane dhe te ekonomise si Tirana dhe Durresi, ka bere qe Komuna e Zall-Herr te kete nje zhvillim te madh me aktivitete private ekonomike dhe industriale. Aktivitetet kryesore te zones jane fabrika e aluminit "Everest" fabrike prodhimi polisteroli "Arkens", qender tregtare "KAIMA CENTER"

### 3.1.3 Perdorimi I tokes

Tokat bujqësore në rajonin e Tiranës, kanë pësuar transformime të konsiderueshme në harkun kohor të njëzet viteve të fundit ,si pasoj e aktivitetit njerëzor të pakontrolluar.

Dëmtimi i zinxhirit të prodhimit bujqësor në rajon ka prekur të gjithë elementët përbërës së tij duke ndërvepruar direkt mbi mjedisin në tërësi si dhe mbi jetën njerëzore.

Politikat territoriale te deritanishme nuk munden te ruanin nje zhvillim te qendrueshem ne Sistemin e Urbanizimit Urban - Rural si pasoje e kerkeses per zhvillim ne hapsira sherbimi dhe banimi, formale dhe informale.

Sistemi i vaditjes se tokave bujqesore dhe sistemi i rezervuareve te rajonit si dhe nderlidhja e tyre me rrjetin e burimeve ujore jane demtuar rende nga mungesa e mirmbajtjes si dhe nga demtimet njerezore.

Sistemi i magazinimit perpunimit dhe nderlidhjes se tregjeve rajonale eshte inekzistent si pasoj e zhvillimit te pakontrolluar dhe ndryshimit te destinacionit te perdorimit te godinave pas privatizimit te tyre ne vitet 1990.

Siperfaqet e tokave bujqesore ne rajon u demtuan rende nga ndertimet formale dhe informale, duke ndryshuar eficencen e tyre ne shfrytezim dhe perdorim si dhe duke ndryshuar statusin e perdorimit te tokes.

### 3.1.4 Punesimi dhe Niveli I jeteses

Sipas te dhenave statistike te marra nga studimi "Living Standards Measurements Survey in 2002 (LSMS)", niveli me I ulet I jeteses haste ne zonat rurale, familjet e te papuneve dhe familjet me shume femije.

Puna ne zonat fshatare paguhet shume me pak se sa ne sektoret e tjere te ekonomise. Sipas nje studimi te kryer ne vitin 2002 te ardhurat nga puna ne bujqesi ishin 2.4 here me te ulta se sa nga puna ne sektoret e tjere te ekonomise dhe 1.7 here me te ulta se sa te ardhurat ne sektoret e vetepunesimit jashte sferes se bujqesise.

Papunesia rrjedh edhe nga niveli I ulet arsimor e social kulturor dhe anasjelltas.Braktisja e shkolles sot nga femijet dot e prodhoje te papune dhe/ose punetore te nenpaguar ne brezat e ardhshem.

Hapja e ketij aktiviteti te ri ne zone do te krijojte vende pune me rreth 26 vende te reja pune, pjesa dermuese e te cileve do te merren nga zona perreth.

### 3.1.5 Arsimi

Sektori i arsimit, luan një rol të rëndësishëm në aspektin afatgjatë të rritjes ekonomike, pasi është burimi kryesor i talenteve të reja dhe profesionistëve të ardhshëm të fushave të ndryshme.

Në këtë moment vihet re një përqendrim më i lartë i shkollave të mesme në hapësirat e qyteteve Tiranë dhe Durrës dhe një përqendrim më i ulët drejtperiferive sidomos në zonën Veriore dhe Veri- Perëndimore të Tiranës (p.sh. Bashkia Kamëz ka 5-së shkolla të mesme) çfarë gjeneron në vetvetë lëvizje të rinjve nga periferitë në qendër, mbipopullim të disa shkollave dhe rënie të cilësisë së shërbimit.

Universitetet shtetërore janë të vendosura kryesisht në Qytetet Tiranë dhe Durrës me përjashtim të Universitetit Bujqësor, i cili ndodhet në Koder Kamëz. Gjatë viteve të fundit, vërehet zhvendosja e një numri të konsiderueshëm Universitetesh private të cilat operojnë në periferitë e qyteteve kryesore.




Figura 4. Shperndarja e institucioneve arsimore ne zonen ne studim.

### **3.1.6 Shendeti dhe infrastruktura shendetesore**

Sistemi shendetesor shtetëror përbehet nga strukturat e shërbimeve përsore, dytesore dhe të rangut të tretë. Shërbimi kryesor (primar), në rrethin e Tiranës, përfaqësohet nga 110 Qendra Shendetesore. Numri i personelit mjekësor është i pamjaftueshëm për arsye të lëvizjes të pa kontrolluar të popullsisë drejt qyteteve të mëdha. Megjithatë përpjekjet për riorganizimin dhe investimet në fushën e shëndetit publik, në ambulancat e shumë zonave mungojnë pajisjet e përshatshme laboratorike mjekësore. Komuna Zall – Herr është shumë afër qendrës së Tiranës ku janë të lokalizuara dhe spitalet si Qendra Universitare Nënë Tereza, Spitali Ushtarak, Spitali Obstretrik Gjinekologjik Mbreterësja Geraldine dhe Koco Glozheni, Spitali i Semendjeve të Mushkerive si dhe shumë struktura private. Spitalet në zonën Tiranë – Durrës janë 57% spitale publike dhe 43% spitale private.

Reformat spitalore janë të përqëndruara drejt përmirësimit të treguesve të shfrytëzimit të spitaleve në drejtim të përqendrimit të shërbimeve në spitale të mëdhenj (kampuse spitalore), në drejtim të aparaturave, shërbimeve më të kualifikuara dhe zgjerimit të shërbimeve të kujdesit spitalor nëpërmjet trajnimit të personelit. Ndërkohë një nga problematikat e sistemit shëndetësor është trafiku rrugor i cili pengon ofrimin e shërbimit të urgjencës në kohë optimale.

## **3.2 Mjedisi biologjik dhe fizik**

### **3.2.1 Flora dhe Fauna**

Në zonën e shfrytëzimit nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me shtetësi të veçantë. Zona është e mbuluar në përgjithësi me barishte dhe shkurre mesdhetare dhe shumë pak nga bimësi e lartë.

#### **3.2.1.1 Flora**

Lista e llojeve të rrezikuara të bimëve në nivel kombëtar është shumë e madhe, gjithsej 319 lloje, nga të cilat janë të rrezikuara në formë kritike 76 lloje, konsiderohen në rrezik 123 lloje dhe të përkeqësuar 120 lloje, të cilat përballen me një rrezik të lartë në kontekstin kombëtar.

Kercenimet kryesore ndaj biodiversitetit janë: zhvillimi industrial, urbanizimi, gjuetia ilegale, peshkimi, erozioni i tokës, energjia dhe minierat, transporti dhe turizmi, sektore këto që kanë ndikim në shumëllojshmërinë biologjike. Aktivitetet antropogjene ku shpyllezimi dhe shkrëtitërimi i tokës së punëshme, aq sa shkatërrimi i livadheve dhe kullotave, kanë pasur një ndikim të madh në ndryshimet e habitateve në të kaluarën e afërt. Ndertimi i rrugëve dhe ndryshimet në rrjedhën e ujit ose ndertimi i digave, ndertimi i tubacioneve, ndotja që vjen nga origjina të ndryshme, zjarret, semundjet dhe ndryshimet klimatike janë arsyt e degradimit dhe fragmentimit të habitateve në Shqipëri. Mbrojtja e biodiversitetit mund të arrihet vetëm duke pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në sektore që lidhen me biodiversitetin, të tilla si bujqësia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi. Shqipëria njihet për një diversitet të lartë të ekosistemeve. Brenda territorit të saj ka ekosisteme detare, bregdetare, liqenore, lumore, shkurre me gjelberim të perhershëm dhe gjethegjere, pyje gjethegjere, pyjet me pisha, kullotat dhe livadhet alpine dhe sub-alpine, dhe ekosistemet e larta malore.

Flora e Shqipërisë përfshin rreth 3250 lloje bimore, ose rreth 30% të flores Europiane (Paparisto et al. 1988). Janë 30 lloje endemike dhe rreth 180 lloje subendemike (Vangjeli et al. 1995). Është e rëndësishme të theksohet se rreth 10% e flores shqiptare, përbehet nga speciet e rralla, speciet e rrezikuara dhe llojet relikte (Vangjeli et al. 1995). Shqipëria është e pasur në burime pyjeve dhe kullotave. Pyjet mbulojnë 1,040,881 ha ose 36% të territorit të vendit, dhe kullotat rreth 400,000 ha ose 15%. Përafërsisht 60% (244,000 ha) e kullotave janë kullotat alpine dhe sub-alpine dhe livadhe. Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve, formacioneve dhe komuniteteve bimore dhe shtazore. Bimet medicinale dhe aromatike (BMA) në Shqipëri, kanë kushte shumë të mira fito-geografike për rritje dhe zhvillim në natyrë. Ato kanë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin social-ekonomik, veçanërisht në rajonet rurale. Bazuar në të dhënat e Inventarit Kombëtar të Bimeve Mjekësore dhe Aromatike të kryer në vitin 1988, fondi i bimeve mjekësore shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej 1183379 ha ose 41.2% të gjithë territorit të vendit. Sipas Fondit Botëror për Natyrën dhe Hartes Ekologjike Digitale të Evropës për Rajonin nga Agjencia Evropiane e Mjedisit, territori i Shqipërisë, mund të ndahet në tri rajone ekologjike: Pyjet ilire gjethërenes, pyjet e perziera dhe pyjet e perziera Dinariko Alpine. Pyjet, sidomos ato veri-verilindore, janë shtëpi për një game të gjërë të gjitarëve, duke përfshirë ujkun, ariun, derrin e eger dhe dhinë e eger.

Gjate viteve të fundit Shqipëria ka arritur progres dhe ka bërë një investim të madh në mbrojtjen e ardhshme të pasurive unike natyrore dhe të peizazhit. Në përputhje me fushat kryesore të punës të identifikuar nga 2000 NBSAP, dhe gjithashtu si rezultat i Programit Kombëtar të Punes për Zonat e Mbrojtura (PKPZM) për periudhën 2006-2009, rrjeti i zonave të mbrojtur është zgjeruar. Që nga viti 1996 sipërfaqja e shpallur ligërisht si zone e mbrojtur në Shqipëri është me shumë se trefishuar (nga 108,475 ha në 378,748 ha), duke e çuar përqindjen totale të zonave të mbrojtura nga 5.7 % në vitin 2002 në 13.17 % në vitin 2011.

Rajoni i Tiranës ka një mbulësë bimore tipike të zonës mesdhetare bregdetare.

Speciet mbizoteruese jane si me poshte:

*Robinia pseudoacacia, Populus tremula, Ficus sp., Rubus sp., Celtys australis, Platanus orientalis, Cornus mas, Arundo donax, Tamus communis, Smilax aspera, Ulmus parvifolia, Hedera helix, Juglans regia, Corylus avellan, Arundo donax, Populus nigra, Populus alba, Rubus sp., Inula viscosa, Salix sp. , Typha latifolia, Populus nigra, Populus alba, Salix sp.*

### 3.2.1.2 Fauna

Sipas perditesimeve me Nentor 2013 te Unionit Nderkombetar per Ruajtjen e Natyres (IUCN), 109 lloje kafshesh te grupeve te ndryshme taksonomike jane konsideruar si te kercenuara, por persa i perket faunes, zona e projektit paraqet specie tipike te zonave rurale.

Rriqebulli, macet e egra, dhe nuselalat jane te rralla, por mbijetojne ne disa pjese te vendit. Ka rreth 760 lloje te kurrizoreve te gjetura deri tani ne Shqiperi. Nder keto ka mbi 350 specie zogjsh, 330 peshq te ujerave te embla dhe detare dhe 80 lloje gjitaresh. Disa prej llojeve me te rendesishme te shpendeve qe gjenden ne vend perfshijne shqiponjen e arte - te njohur si simbol kombetar te Shqiperise - specie te hutave, Capercaillie dhe shpend uji te shumte.

Ekosistemet bregore paraqesin nje biodiversitet me interesant pasi ata paraqesin bimesi bregore natyrore dhe keshtu terheqin faunen qe lidhet me ekosistemet bregore.

Tab.2 Llojet kryesore te insekteve te zones ne studim

Nr	Emri shkencor	Statusi kombetar
	<b>Rendi odonata</b>	
1	<i>Sympetrum sanguineum</i>	
	<b>Rendi Orthoptera</b>	
2	<i>Gryllulus frontalis</i>	
3	<i>Calliptamus italicus</i>	
4	<i>Locusta migratoria</i>	
	<b>Rendi Coleoptera</b>	
5	<i>Scarabaeus sacer</i>	
6	<i>Calosoma sycophanta</i>	VU
7	<i>Gyrinus notator</i>	DD

8	<i>Anomala vitis</i>	
9	<i>Oxythorea funesta</i>	
10	<i>Cetonia aurata</i>	
11	<i>Lampyrus noctiluca</i>	
12	<i>Coccinella septempunctata</i>	
	<b>Rendi Lepidoptera</b>	
13	<i>Iphiclides podalirius</i>	
14	<i>Papilio machaon</i>	
15	<i>Aporia crataegi</i>	
16	<i>Pieris brassicae</i>	
17	<i>Colias crocea</i>	
18	<i>Gonepteryx Cleopatra</i>	
19	<i>Maniola jurtina</i>	
20	<i>Melanargia galathea</i>	
21	<i>Cynthia cardui</i>	
	<b>Grupi Noturna</b>	
22	<i>Zygaena carniolica</i>	
23	<i>Macroglossum stellatarum</i>	
24	<i>Pelosia muscerda</i>	
	<b>Rendi Neuroptera</b>	
25	<i>Libelloides ottomanus</i>	VU
26	<i>Mantis religiosa</i>	LR (nt)

## Herpetofauna (Amfibet dhe Reptilet)



Sic shihet llojshmeria e amfibeve eshte relativisht e ulet edhe per reptile jemi ne te njejten situate, me pak lloje te pranishme.

Tab.3 Llojet kryesore te amfibeve te pranishem ne zone

Nr	Emir shkencor	Statusi Kombetar
1.	<i>Bombina variegata</i>	LR (nt)
2.	<i>Bufo bufo</i>	LR (nt)
3.	<i>Bufo viridis</i>	LR (nt)
4.	<i>Rana balcanica</i>	VU



Bufo bufo



Rana balcanica

Tab.4 Llojet kryesore te reptileve te pranishem ne zone

Nr	Lloji	Statusi Kombetar
1.	<i>Testudo hermanni</i>	LR (nt)
2.	<i>Anguis fragilis</i>	NE
3.	<i>lacerta trilineala</i>	LR (lc)
4.	<i>Lacerta viridis</i>	LR (lc)
5.	<i>Podarcis muralis</i>	NE
6.	<i>Columber germonensis</i>	LR (nt)



Anguis fragilis



Podarcis muralis

Nga krahasimi I listes te llojeve te amfibeve e reptileve ne listen e kuqe te Shqiperise rezulton nje numer I madh llojesh qe I perkasin kategorive te llojeve te rrezikuara ne nivel kombetar.

### Ornitofauna (Shpendet)

Pjesa me e madhe e shpendeve te hasur ne kete territori jane dimerues dhe shtegtare, lloje qe preken me pak nga shqetesimi apo nderhyrje te tjera humane. Shpendet e perhershem dhe ata folezues te mirefillte jane dhe me te rralle. Ne menyre jot e dretperdrejte ky fakt deshmon pakesim e llojeve te cilet kane nevoje per qetesi te plote.

Shpendet e takuar I perkasin mjedisve te tipit te shkurretave, toka bujqesore te punuara apo te braktisura dhe qendrave te banuara.

Nder ta me te zakonshem jane harabeloret me perfaqesues bilbithat e trishtilat. Ne tokat bujqesore hasen me shpesh laureshat, bishtlekundesat, avdosat etj. Qendrat urbane strehojne shpend te pershtatur ndaj pranise se vazhdueshme te njeriut si dallendyshet, harabelat, kukuvajkat dhe laraskat.

Tab.5 Lista e llojeve te shpendeve

Nr .	Lloji	Statusi Kombetar
1.	<i>Accipiter nisus</i>	EN
2.	<i>Buteo buteo</i>	EN
3.	<i>Falco tinnunculuc</i>	EN
4.	<i>Coturnix coturnix</i>	
5.	<i>Streptopelia decaocto</i>	

6.	<i>Apus apus</i>	
7.	<i>Galerida cristata</i>	
8.	<i>Alauda arvensis</i>	
9.	<i>Hirundo rustica</i>	
10.	<i>Hirundo daurica</i>	
11.	<i>Delichon urbica</i>	
12.	<i>Anthus campestris</i>	
13.	<i>Anthus pratensis</i>	
14.	<i>Motocilla cinerea</i>	
15.	<i>Motocilla alba</i>	
16.	<i>Troglodytes troglodytes</i>	
17.	<i>Sylvia atricapilla</i>	
18.	<i>Phylloscopus collybita</i>	
19.	<i>Phoenicurus ochruros</i>	
20.	<i>Saxicola torquata</i>	
21.	<i>Turdus pilaris</i>	
22.	<i>Parus caeruleus</i>	
23.	<i>Parus major</i>	
24.	<i>Lanius collurio</i>	
25.	<i>Pica pica</i>	
26.	<i>Corvus corone cornix</i>	
27.	<i>Sturnus vulgaris</i>	
28.	<i>Passer domesticus</i>	
29.	<i>Passer hispaniolensis</i>	

30.	<i>Passer montanus</i>	
31.	<i>Frigilla coelebs</i>	
32.	<i>Serinus serinus</i>	
33.	<i>Carduelis chloris</i>	
34.	<i>Carduelis carduelis</i>	
35.	<i>Carduelis cannabina</i>	
36.	<i>Miliaria calandra</i>	
		<b>3 lloje</b>

Vetem tre lloje shpendesh jane te rezikuara ne shkalle kombetare duke treguar keshtu se impakti I aktivitetit do te ishte pergjithesisht I neglizhueshem. Qe te tre bejne pjese ne rendin e rrembenjesve.

### **Mammalofauna (Gjitaret)**

Nga vrojtimet ne terren dhe shqyrtimi I burimeve bibliografike te mundeshme mbi gjitaret e zones eshte bere e mundur te hartohet nje liste e llojeve te pranishem ne zonen e studimit.

Tab.6 Llojet kryesore te gjitareve te pranishem ne zonen ne studim.

<b>Nr.</b>	<b>Lloji</b>	<b>Statusi Kombetar</b>
1.	<i>Erinaceus concolor</i>	
2.	<i>Talpa caeca</i>	
3.	<i>Crocidura leucodon</i>	
4.	<i>Pipistrellus kuhli</i>	
5.	<i>Pipistrellus pipistrellus</i>	
6.	<i>Mus musculus</i>	

7.	<i>Mus spicilegu</i>	
8.	<i>Rattus norvegicus</i>	
9.	<i>Rattus rattus</i>	
10.	<i>Vulpes vulpes</i>	
11.	<i>Meles meles</i>	
12.	<i>Mustela putorius</i>	EN

Nga krahasimi I listes se mesiperme ne listen e kuqe te Shqiperise dhe anekset e disa konventave nderkombetare ne te cila Shqiperia eshte pale, rezulton se vetem nje lloj I perket kategorive te llojeve te rrezikuara ne nivel kombetar. Kjo njeherazi deshmon per rendesine e paket te zones ne studim ne nivel kombetar.

### 4.3 Gjeologjia

Zona ne vleresim ndertohet nga depozitime te trajtuara:

- Depozitime te kuarternarit
- Depozitime Molasike te Neogjenit

Depozitimet e kuarternarit: Depozitimet detare perfaqesohen nga zhavorre kokerr vogel deri ne zhure, rera, surera, suargjila, argjila dhe shtresa trofike. Jane depozitime pak deri ne mesatarisht te konsoliduara, takohen ne te gjithë zonen ku do te ndertohet objekti.

Depozitimet e Neogjenit: nen keto depozitime takohen depozitimet e Neogjenit qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite me ngjyre gri me cimentim te dobet deri ne mesatar, pjesa e sipërme e ketyre depozitimeve eshte e perajruar. Fenomenet me te dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe verehen ne kete zone jane:

Fenomeni i perajrimit, i cili eshte i dukshem te formacionet rrenjesore qe perbehen nga argjile dhe alevrolite, keto shkembinj jane depozitime te reja dhe me cimentim te dobet argjilor.



Fig. 5- Harta gjeologjike e zones

### 3.3.1 Stratigrafia

Rajoni I Tiranës dhe Durrësit ndertohet nga depozitimet terrigjene te sistemit mio-pliocenik dhe kuaternarit, te cilat sipas perberjes litologjikeklasifikohen ne dy grupe te medha:

1. Formacioni molasik; dhe
2. Depozitimet kuaternare

#### 3.3.1.1 Formacioni molasik

I perket moshave Miocen I mesem ( $N_1^2$ ) – Miocen I siperm ( $N_1^3$ ) – Pliocen. Litologjikisht ndahen ne njesi te rendeve te ndryshme:

##### Depozitimet e Miocenit te mesem

Perfaqesohen nga:

1. Pakoja e poshteme argjilo – ranore.
2. Pakoja e mesme argjilore.
3. Pakoja e siperme argjilo-ranore.

### Depozitimet e miocenit te siperme

#### *Depozitimet e Tortonianit ( $N_1^{3t}$ )*

Perbehen nga nderthurje ranoresh me ato argjilore qe marrin pjese ne ndertimin e structures antiklinale te Peze-shijakut dhe monoklinalit te Prezes. Depozitimet e tortonianit kane trashesi te konsiderueshme nga 1700-3270m.

#### *Depozitimet e Mesinianit ( $N_1^3$ )*

Keto depozitime shtrihen normalisht mbi ato te nenshtruara, te Tortonianit. Ne keto depozitime dallohen qarte dylitofacie: litofacia gipsmbajtese dhe litofacia jogipsmbajtese. Ne zonen e ndertimit haste litofacia jogipsmbajtese, e cila perfaqesohet kryesisht nga ranore massive te nderthurur me conglomerate dhe zhavore.

#### *Depozitimet e Pliocenit ( $N_2$ )*

Depozitimet e Pliocenit te mesem ( $N_2^2$ ), nga pikepamja litologjikendahen ne dy formacione:

- Formacioni Helmesi, me mbizoterim argjilash
- Formacioni Rrogozhina, me mbizoterim ranoresh.

### **3.3.1.2 Depozitimet kuaternare**

Kane perhapje te gjere, duke mbuluar te gjitha pjesen e ulet te relievit. Ne rajonin e studimit ato shfaqen me te gjitha tippet e tyre gjenetike: depozitime deluviale lagunore – kenetore, aluviale dhe detare.

Depozitimet deluviale ( $Q_4^{dl}$ ), jane te shperndara me teper ne rreze te faqeve te kodrave ne lindje nga subargjila subrera, rera, gravelite dhe zaje me trashesi 2-5m dhe 10-12m.

Depozitimet aluviale ( $Q_4^{al}$ ) dhe laguore kenetore ( $Q_4^{kt}$ ) mbushin gjithe rajonin e studimit e me gjere.

## **3.4 Tektonika**

Rajoni ne studim ben pjese ne brezin strukturor perendimor te UPM, ku pergjithesisht pranohen marredhenie suksesive te depozitimeve. Karakteristike jane ndertimi I komplikuar tektonik,

sedimentet kane trashesi te fuqishme si dhe prania e strukturave antiklinale dhe sinklinale me shtrirje veri-veriperendim, te formuara gjate fazes tektonike pliocen-kuaternar.

Rajoni I Tiranes nga ana tektonike ndahet ne tre elemente strukturale:

Ne sinklinalin e Erzenit te poshtem, me harkun lindor monoklinalin e Pezes, pjesa e veriut antiklinali I Kavajes dhe sinklinali I Durresit.

Lugina e Erzenit te poshtem, perfaqeson ne vetevete pjesen e nje depresioni te thelle e te mbushur me depozitime kuaternare siperfaqesore nen te cilat shtrihen depozitimet Pliocenike. Lugina ka forme ovale. Boshti I saj ka shtrirje veriperendim-juglindje.

Nga jugu lugina e Erzenit te poshtem kufizohet nga antiklinali I Kavajes qe eshte nje structure jo e madhe me bosht veriperendimor. Ne berthame ka depozitime Burdiglianit, ndersa ne krah dhe ne periklinale depozitime te Tortonianit deri ne Pliocen. Gjate sharnierit kjo structure komplikohet nga nje prishje tektonike, e cila ne pjesen jugore kalon ne kahun perendimor te saj.

Krahu lindor I antiklinalit te Durresit, ne te cilin ben pjese edhe zona e vendosjes se objektit, ndertoht nga argjila te miocenit te siperm, nga pakoja e fuqishme e ndershtrezimeve te argjilave dhe ranoreve te moshes Pliocenike. Sipas te dhenave te puseve kahu lindor I kesaj strukture shkeputet tektonikisht.

### 3.4.1 Neotektonika

Rajoni I Tiranes , sikuresse e gjithë Ultesira prane adriatike eshte kapur nga nje levizje shtypese paspliocenike dhe eshte formuar nga rrudha larterreshqitese, mbihypje dhe kundrahypje, si dhe shtytje. Levizjet shpypese vazhdojen dhe sot.

Ne baze te intensitetit dhe kronologjise se levizjeve vertikale ne Ultesiren anesore Praneadriatike vecohen keto elemente siperfaqesore:

- Ngritje mesatare te fuqishme nga plioceni.
- Zhytje mesatare deri te fuqishme ne pliocen dhe ngritje e dobet ne kuaternar.

Rajoni I Tiranes eshte kapur nga zhytja e fuqishme ne pliocen dhe kuaternar.

Struktura e rrudhosur e Ultesires Praneadriatike I nenshtrohet dy fazave shtypese:

- Njera me e dobet ne kufirin Miocen-Pliocen.
- Tjetra me e fuqishme ne Pleistocen te poshtem.






Fig. - Paraqitje skematike e strukturave gjeologjike ne rajonin e studimit.

Deformimet shtypese vazhdojne deri ne dite tona. Rajoni I Durrësit ndertohet nga disa linja antiklianle relativisht te ngushta (nga studimet gjeofizike te kryera edhe ne det) dhe sinklinale te gjera, lineare Mio-Pliocenike me shtrirje veriperndim deri afer verior. Nga perendimi ne lindje evidentohen keto struktura mio-pliocenike:

- Linja antiklinale Lushnje – Kavaje qe mbyllet ne gjirin e Lalzit.
- Sinklinali I Erzenit te poshtem, I cili vazhdon ne drejtim te veriut, deri ne detin Adriatik.
- Monoklinali I Pezes
- Sinklinali I Tiranës ndiqet pjeserisht ne det deri tek terthorja e Lezhes.

Depozitimet kuaternare detare dhe aluviale, si rregull kane nje trashesi deri 150-200m dhe shtrihen horizontalisht mbi malosen e rrudhosur miocenike-pliocenike.

Nga interpretimet gjeologjike te bera per shkeputje gjatesore te medha dhe rrudhat antiklinale Mio-Pliocenike qe I shoqerojne ato ne Ultesiren Praneadriatike rezulton se mbihipjet dhe kundrahijet jane ende active ne ditet tona, kete e deshmojne termetet e fuqishme te gjeneruara prej tyre.

### 3.5 Sizmiologji

#### 3.5.1 Tektonika rajonale dhe Sizmiciteti

Shqiperia perfshihet ne brezin orogjenik alpin mesdhetar, i cili eshte rezultat I levizjes se pllakave te medha tektonike (Afrika dhe Euroazia) dhe nje sere pllakash te vogla (pllaka e Adrias). Territory shqiptar kufizohet ne perendim te tij me buzen lindore te mikropllakes se Adrias. Si rezultat I ketyre levizjeve shtytese orogjenike, ne brezat e rrudhosur qe rrethojne mikropllaken e adrias, gjenerohet nje aktivitet I larte sizmik, I cili prek dhe vendin tone.

### 3.5.2 Sizmiciteti ne territorin shqiptar

Territori shqipetar karakterizohet nga nja aktivitet I larte sizmik. Ne figuren e meposhteme jepen vatrat dhe magnitudo e termeteve instrumentale, te rregjistruar ne periudhen 1964-2000.

Pjesa me e madhe e epiqendrave te termeteve me te fuqishem, qe prekin kete territor shtrihen ne 3 breza sizmike (Sulstarova et al., 1980; Aliaj et al., 2004), misdis te cileve ben pjese edhe brezi termotor Joniko-Adriatik, me orientim veriperndim-juglindje, I shtrire pergjate buzes lindore te mikropllakes se Adrias. Ne kete brez sizmik perfshihet dhe zona jone e studimit.

Thyerjet terthore qe kalojne ne very te ishullit te Sazanit dhe prane qytetit te Lezhes, e ndajne brezin termotor Joniko-Adriatik ne tre zona sizmogjene ndert te cilat edhe zona e Ultesires Praneadriatike (PL), ku ben pjese edhe zona e ndertimit te objektit te ketij studimi.

Fenomenet tektonike, qe prekin territorin e Shqiperise u perkasin fazave te ndryshme rrudhosese. Paraqitja aktuale e tyre lidhet me fazen e fundit rrudhosese Plio-Kuaternare, e cila dallohet nga nje amplitudo e larte e levizjeve tktonike. Gjate kesaj faze pervec riaktivizimit te thyerjeve te mepareshme jane formuar edhe disa thyerje te reja, qe ne gjeologjine shqiptare njihen me emrin tektonika e re pas Pliocenike.

Zona e Ultesires Praneadriatike (PL) karakterizohet nga nje shkeputje tektonike mbihypese oblike me shtrirje very dhe very-veriperendim si dhe prishje te rralla tektoike gjate shtrirjes me drejtim lindje-verilindje. Potenciali I intesitetit sizmik te pritshem te kesaj zone eshte VIII balle (klasifikimi MSK-1964).

### 3.5.3 Sizmiciteti ne zonen e studimit

Zona ne studim perfshihet ne zonen e burimeve sizmike te Ultesires Praneadriatike, te vleresuar me magnitudo maksimale te pritshme te termeteve  $M_{max} = 7.0$ . Ne kuader te krahines se Duresit , ku ben pjese, kjo zone I perket njerës prej zonave sizmogjene me potencial sizmik te pritshem nga me te Lartet e territorit te Shqiperise. Vlerat e larta t ketij potenciali I detyrohen faktit se gjeografikisht kjo zone ndodhet prane ballit mbihypes te orogjenit Shqipetar, ne konvergjenca me mikropllaken e Adrias. Amplitudo e larte e levizjeve shtypese, qe linden si pasoje e kesaj konvergjenca krijon kushte per termite te forta, magnitudo e te cileve arrin potencialisht deri ne  $M = 7.0$ .

### Tektonika dhe Sizmiciteti lokal

Edhe shkeputja kunderhypese, qe prek anen lindore te structures se Durresit, I perket tektonikes pas pliocenike. Kjo shkeputje kalon neper pjesen veriore te antiklinalit te Kryevidhit ne gjirin e Durresit, ne lindje te antiklinalit te Durresit dhe ne Bishtin e Palles. Fakti qe thyerja e mesiperme prek edhe depozitimet detare kuaternare, tregon qe ajo eshte active edhe ne ditet e sotme.

Aktiviteti tektonik I zhvilluar pergjate shkeputjeve ne pernedim dhe lindje te qytetit te Durresit dhe nyjeve te nderprerjes se tyre, qendrojne ne origjinen e aktivitetit sizmik te kesaj zone.

### 3.6 Tokat

Zona ne studim perfaqesohet nga tokat e hinjta. Tokat e Hinjta Kafe jane te perqendruara ne malet e uleta dhe kodrat e zones bregdetare ndermjet lartesisive 0 dhe 200 m mbi nivelin e detit (ne disa zona shtrihen deri 600 m lartesi). Duke filluar nga bregu i detit, ato shtrihen ne brendesi te territorit, ne thellesi 80 - 100 km. Formimi i tokave te Hinjta kafe eshte kushtezuar nga klima Mesdhetare kodrinore dhe fushore. Sipas treguesve hidrotermike, ne kete brez tokesor dallohen dy zona klimatike: zona Mesdhetare fushore dhe zona mesdhetare kodrinore.

Materiali primar. Tokat e Hinjta Kafe formohen ne materiale primare me nature te ndryshme, si proluviale, diluviale, aluviale dhe liqenore. Keto te fundit paraqiten me teksture, perberje mineralogjike dhe kimike te ndryshme. Depozitimet proluviale ndeshen mjaft rralle dhe vetem ne fundin e shpateve shume te pjerreta te kodrave. Ato jane te paseleksionuara. Depozitimet deluviale vendosen ne pjesen fundore te shpateve te pjerreta te kodrave. Kane ngjyre te hirte ne te verdhe, perberje mekanike subranore e subargjilore, si dhe permbajne karbonate. Pjesa e trashe e tyre perbehet kryesisht nga kuarci, ndersa pjesa e imet nga hidromikat dhe mineralet e dyta te grupit te montmorilonitit. Pjesa e imet e depozitimeve subargjilore me ngjyre te kuqe perbehet nga hidromikat, caoliniti dhe oksidet e hidratuara te Fe.

Tokat e Hinjta Kafe kane profil te diferencuar ne shkalle te ndryshme. Profili eshte A1-A2-AB-BC-C ose A-AB-B-C ose A-AC-C.




Fig.6- Harta pedologjike e rajonit

### 3.7 Pershkrimi i pejsazhit te zones

Relievi i Shqiperise eshte kryesisht malor. Vargmalet e para alpine u formuan nga mbarimi i jurasikut, ndersa gjate eres kenozoike u shpejtua procesi malformues ne teresine e Albanideve, qe tani perbejne token e nentoken e Shqiperise. Lartesia mesatare e relievit eshte 708 metra, ose 2 here me e larte se mesatarja e Evropes. Lartesite me te medha gjenden ne Alpet shqiptare dhe ne malet e Lindjes (Korabi 2751 metra mbi nivelin e detit, perben edhe majen me te larte te Shqiperise).

Territori i Shqiperise ndahet ne 4 regjione te medha natyrore (fiziko-geografike):

- Rajoni Verior dhe Verilindor
- Rajoni i malore qendrore
- Rajoni i maleve jugore
- Ultesira perendimore

Fushat zene kryesisht pjesen perendimore, pergjate bregdetit Adriatik, por ka edhe ne pjese te tjera te vendit. Fushat me te larta jane ato te pellgut te Korçes, mbi 800 metra mbi nivelin e detit. Fushat gjenden kryesisht pergjate lumenjve kryesore si: Vjose, Devoll, Osum, Shkumbin, Erzen, Mat e

Drin, ku gjenden, gjithashtu, edhe tokat bujqesore e qendra te medha banimi, si dhe pershkohen nga rruge te rendesishme lidhjesh.

Nga Krahina Malore Veriore vlen te veçohen Alpet Shqiptare qe shquhen per kontrast te madh midis maleve te larta dhe luginave te thella. Rreth 30 maja malesh ndodhen mbi 2 500 m mbi nivelin e detit. Nder luginat dallohen sidomos lugina e Valbones dhe ajo e Thethit. Krahina Malore Qendrore nuk eshte aq kompakte sa ajo veriore, por e ndare ne disa masive malore, si: Vargu i Korabit, Malet e Lures, Malet e Skenderbeut etj. Keto male nderpriten nga lugina te ndryshme. Krahina Malore Jugore arrin deri ne detin Jon ne jug dhe eshte e copetuar ne disa vargje malore dhe lugina lumore. Vend te veçante ne te ze riviera shqiptare, e cila shtrihet nga Gjiri i Vlores deri ne Butrint ne jug. Pergjate bregdetit Adriatik, ne perendim te vendit shtrihet Ultesira Perendimore e Shqiperise me gjatesi nga veriu ne jug rreth 200 km dhe me gjeresi nga perendimi ne lindje, deri ne 50 km. Kjo ultesire perben ultesiren me te madhe ne pjesen perendimore te Ballkanit dhe eshte rajoni me i zhvilluar ekonomik i Shqiperise.

Relievi i tokave shqiptare shtrihet nga niveli i detit deri ne lartesine 2751m (mali i Korabit). I gjithë ky ndryshim i lartesisë ndikon ne ndryshimet e medha klimaterike, ne bimesi, si dhe ne dendesine e vendosjes se qendrave te banuara ne drejtim vertikal. Ne relievin e tyre mbizoterojne kodrat dhe malet. Duke u nisur nga lartesia mbi nivelin e detit, dallohen: relievi i ulet, i mesem dhe i larte. Relievi i ulet shtrihet nga niveli i detit, deri ne 200 m mbi kete nivel. Ai perfshin fushat dhe kodrat e uleta prane brigjeve detare te Adriatikut e Jonit dhe pergjate sektoreve te mesem te luginave lumore. Relievi i mesem shtrihet nga 200 deri ne 1000m mbi nivelin e detit. Ai ka shtrirjen me te madhe dhe perfshin: kodrat, gropat, fushegropat dhe luginat kryesore. Relievi i larte shtrihet 1000 m mbi nivelin e detit dhe perfshin malet dhe sistemet malore. Pjesa me e madhe e ketyre maleve ka lartesi deri ne 2000 m. Malet me lartesi me te madhe se 2000 m kane shtrirje te kufizuar

### **3.8 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyre**

Zona ne fjale nuk ben pjese ne asnje kategori te zonave te mbrojtura dhe nuk mbart vlere kulturore dhe historike per vendi.




Fig. 7 Harta e zonave te mbrojtura

### 3.9 Karakteristikat klimatike të zonës

Zona ne studim perfshihet ne zonen klimatike mesdhetare fushore te Shqiperise. Kjo zone karakterizohet nga dimer te bute dhe te laget dhe vere te nxehte dhe te thate. Vendmatjet kryesore te vecorive klimatike jane ne Tirane, Kamza, dhe Sukthi.




Fig 8 -Zonat klimatike te Shqipërisë

Vleresimi i vecorive klimaterike te rajonit eshte bere duke u bazuar ne te dhenat shume vjecare te vrojtuara ne stacionet metereologjik i Kamzes.

Temperatura mesatare vjetore	15.5°C
Temperatura mesatare e Janarit	7°C
Temperatura mesatare e Gushtit	24°C
Temperatura absolute me e ulet ka zbritur ne	-9°C
Temperatura absolute me e larte ka arritur	39°C-43°C
Sasia mesatare vjetore e reshjeve	963 mm
Sasia maksimale vjetore	1542 mm
Sasia minimale vjetore	637.7 mm
Ore me diell ne vit	2786 ore
Lageshtia mesatare vjetore	70%
Shpejtesia e eres me e madhe sipas muajve	24-40m/sek

Drejtimi kryesor i eres veri-juglindore, perendimore.

### 3.9.1 Rreshjet

Për shkak të veprimtarisë së gjere ciklonare sasia më e madhe e reshjeve vihen re në gjysmën e ftohtë të vitit, dhe ajo më e ulet në periudhën e ngrohtë të tij. Zona në studim është një nga zonat që karakterizohet nga sasi reshjesh vjetore të ulta mesatarisht 931mm në vit të cilat bien kryesisht në formë shiu.

Muaji me më shumë reshje është muaji nëntor (132.9 mm), i ndjekur nga muaji dhjetor (113 mm). Muaji me më pak reshje është muaji korrik me 23.9 mm. Numri i ditëve me reshje  $\geq 1.0$  mm varion nga 2.4 ditë (korrik) deri në 11.1 ditë (dhjetor). Gjatë vitit ka mesatarisht 86.4 ditë me reshje  $\geq 1.0$ mm.

Zona në studim nuk klasifikohet si zone me sasi të medha reshjesh 24-oreshe, ose me mire ajo bën pjesë në zonat ku shirat janë me pak të rrembyeshem. Megjithatë nuk përjashtohen edhe rastet kur sasia maksimale 24-oreshe ka arritur 180.8mm dhe 182.5mm perkatesisht në muajt nëntor dhe tetor. Ndërsa maksimumi 24h për periudhën 30 vjeçare varion nga 43.0 mm në korrik (për vlerën me të ulet) deri në 182.5 mm në tetor të vitit 1962.

Rreshjet janë një element i rëndësishëm meteorologjik, që në rajonin e Tiranës kryesisht përfaqësohen nga shiu. Në tabelën me poshtë paraqitet sasia e rreshjeve sipas muajve dhe numri i ditëve me rreshje gjatë vitit bazuar në të dhënat shumë vjeçare meteorologjike.

**Tabela nr.8 : Sasia e reshjeve mujore dhe numri i ditëve me reshje gjatë vitit bazuar në të dhënat shumë vjeçare meteorologjike**

Muajt		01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Vjetor
Reshjet														
Reshjet mujore mm		112	98	86	60	57	28	12	20	35	131	164	150	983
Max 24 oresh mm		89	83.6	63	66.1	67	77	35	65.3	72.3	182.5	180.8	59	1042.6
Numri i ditëve me reshje	0.1 mm	13.3	11.5	10.7	8.8	7.5	4.9	3.5	3.5	5.7	10.7	12.4	14.4	106.9
	5 mm	6.1	5.5	5.1	3.5	3.3	1.8	1.0	1.5	2.5	5.4	8.5	7.2	51.4
	10 mm	4.2	3.3	2.7	1.9	1.9	0.9	0.5	0.9	1.6	3.6	5.5	4.1	31.1



### 3.9.2 Temperatura e ajrit

Ne rajonin e Tiranës, temperatura e ujit është me e lartë në muajt e verës (Korrik - Gusht), ku edhe sasia e energjisë diellore është me e madhe, ndërsa temperatura me e ulët është në dimër, në muajin Shkurt. Përse i përket vecorive sezonale mund të pohojmë që gjysma e ngrohtë e vitit prill-shtator karakterizohet nga temperatura mesatare 20.6°C ndërsa gjysma e ftohtë 12.4 °C. Ecuria vjetore e temperaturave maksimale absolute të ajrit është e njëjtë me atë të temperaturave mesatare, pra me një minimum në janar dhe maksimum në korrik ose gusht. Temperaturat maksimale absolute >30°C fillojnë të regjistrohen që nga muaji maj dhe vazhdojnë deri në shtator. Temperatura maksimale absolute me e lartë e vrojtuar është 38.6°C në Korrik (viti 1988). Një nga treguesit më të rëndësishëm për të karakterizuar temperaturat maksimale të ajrit është dhe mesatarja maksimale, vlerat e se cilës variojnë nga 12°C në janar deri në 27.8°C në korrik. Në këto zona vrojtohen vlera jo shumë të ulta të temperaturës minimale absolute. Shfaqja e vlerave negative të këtij treguesi nuk është ngjarje e rrallë. Këto vlera sigurojnë që janë të pranishme në gjysmën e ftohtë të vitit. Minimumi absolut i tyre arrihet në muajin janar (-6.0°C). Por duhet përmendur gjithashtu edhe vlera të ulta të këtij treguesi janë vrojtuar qysh në nëntor (-1.6°C) deri në muajin mars (-5.2 °C). Kjo zonë, ashtu si edhe në rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga një numër i madh i orëve me diell. Mesatarisht gjatë vitit ka 2655 orë me diell, me vlerën më të lartë në korrik me 355 orë dhe atë më të ulët në dhjetor me 107 orë.

**Tabela nr.9 : Temperatura përgjatë vitit në Durrës dhe në Tiranë**

Temperatura		Mujore	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
Mesatare 0C			7.9	8.8	11.0	14.4	18.1	21.9	24.0	23.9	21.4	17.6	13.7	10.0
Mesatarja mujore	Me e larta		-11.6	11.7	14.2	16.6	20.7	23.8	26.2	25.8	24.0	20.2	15.8	12.1
	Me e ulta		4.1	5.4	7.8	11.9	16.7	19.4	22.7	21.0	19.6	15.2	11.9	6.4
Max.absolute			18.8	22.1	24.9	28.6	31.3	35.0	37.7	39.0	34.0	32.2	26.0	21.7
Min.absolute			-7.4	-4.6	-3.0	2.4	6.2	11.0	13.6	11.0	8.2	5.0	2.0	-7.2

### 3.9.3 Diellezimi

Rajoni merr sasi te medha orresh diell. Vlera e zgjatjes vjetore te djellezimit leviz ne kufijte 2600-2700 ore. Edhe numeri I diteve me diell leviz nga 320-330 dite. Vlerat me te larta jane vrojtuar ne korrik, 373 ore me diell, dhe me te ultat ne dhjetor 118 ore.

Edhe radiacioni diellor ndjek pothuaj te njejten shperndarje vjetore si dhe djellezimi. Energjia diellore mesatare gjate nje viti eshte 1600 kW ore/m<sup>2</sup>, vleit me te larta jane vrojtuar ne korrik, 223.5 kW ore/m<sup>2</sup> dhe me te ultat ne dhjetor 52.9 kW ore/m<sup>2</sup>. ne tabelen e meposhtme jane dhene mesataret shumevjecare mujore te shperndarjes se djellezimit si dhe radiacioni diellor I pergjithshem.

**Tabela nr. 10: Diellezimi (ore) dhe radiacioni diellor (kW h/m<sup>2</sup>)**

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	6.5	5.8	5.2	4.6	5.5	8.1	17.3	17.6	13.5	9.6	6.1	6.1	105.9
Kamez	5.7	5.5	4.7	4.6	5.7	8.0	16.2	16.0	12.3	9.6	5.6	6.1	100
Sukth	7.7	7.2	6.8	6.8	8.7	12.0	19.0	18.4	15.4	11.1	7.3	7.2	127.6

**Tabela nr. 11: Vlera mesatare e diteve me re**

Stacioni I monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	12.3	12.6	12.2	11.7	7.2	4.3	1.2	1.8	3.6	7.2	11.9	12.7	98.7
Kamez	12.4	10.9	10.3	9.9	6.1	3.9	0.8	1.4	2.3	6.3	11.0	11.6	86.9
Sukth	10.	10.2	9.2	7.6	4.6	3.3	0.7	1.3	2.9	5.0	9.7	10.6	75.1

**Tabela nr.12: Vlera mesatare e rrezatimit**

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	142.9	208.3	300	358.1	476.8	549.1	570	511	398.7	270	172.5	135.6	4093

### 3.9.4 Era

Ndikimi I Adriatikut eshte I dukshem sidomos per sa I perket shpejtesise se eres dhe rregjimit te saj karakteristik gjate stines se veres. Ererat jane nje element mjaft I rendesishem per gjeografine dhe agrometereologjine e rajonit. Kjo lidhet jo vetem me qarkullimin e pergjithshem t atmosferes por dhe me relieving dhe afersine e detit. Era ka karakterin e puhizes detare vecanerisht gjate sezonit te nxehte, dmth gjate dites era fryn nga deti ne toke, ndersa gjate nates nga toka ne drejtim te kundert. Drejtimi mbizoterues I eres ndryshon sipas stineve. Gjate periudhes se veres era

dominuese fryn nga kuadranti I perendimit, nersa gjate periudhes se dimrit era fryn nga kuadranti I lindjes.

Nr	Elemente	No era	Drejtimi							
			V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
1.	Shperndarja vjetore drejtimit ne%	11.9	27.5	2.9	4.3	16.7	8.2	4.7	12.5	8.1
2.	Shpejtesia mesatare, m/s	-	3.3	2.4	3.5	4.5	6.7	5.8	4.9	4.4

Tabela 13. – Intensiteti i eres sipas drejtimeve




Fig 9 - Trendafil i eres

Sic shihet periudhat pa ere perfaqesojne 11.9% te rasteve te pergjithshme te drejtimit te eres. Duke ju referuar tabelës dhe trendafilin te eres verejme qe drejtimi verior, N eshte mbizoteruesi me 27.5%, kurse vlerat minimale te rasteve jane sipas drejtimit verilindor NS me 2.9%. Mesatarja e shpejtesive sipas ketyre drejtimeve respektivisht jane: 3.3 dhe 2.4 m/s.

Tab.14 Mesatarja e shpejtesise se eres sipas stineve

Nr.	Stinet	Shpejtesia m/s
1	Dimri (XII-I)	4.9
2	Pranvera (III-V)	4.4
3	Vera (VI-VIII)	3.9
4	Vjeshta (IX-XII)	4.3
5	Vjetore (I-XII)	4.4

Duke ju referuar tabelës së mësipërme shpejtesia mesatare në stinën e dimrit është 4.9 m/s, ndërsa mesatarja vjetore 4.4 m/s.

Ererat e forta që fryjnë sipas drejtimeve veri, N e juglindje SE me shpejtesi 40-45 m/s kanë në përgjithësi kohezgjatje të kufizuar, kështu që ndikimi i tyre në rregjimin e valesimit është i vogël. Ererat me shpejtesi 10-20 m/s jo vetëm kanë rastisje më të mëdha por kanë dhe drejtim më të qendrueshëm. Në këto kushte shpejtesia e erës 20 m/s është përzgjedhur si shpejtesi për vlerësimin e valesave maksimale llogaritese për qëllime projektimi.


### 3.9.5 Rrjeti hidrografik i zones në studim

Zona në pikëpamje të infiltrueshmerisë karakterizohet nga grupime shkëmbinjsh dhe dherash:

- zhavorre proluviale
- suargjila deluviale
- shkëmbinjte argjilo-alevrolitiko-ranore të Neogjenit ( $N^{3/4}$ )

Nga vrojtimet të kryera nga shpimet është konstatuar se niveli i ujerave nentokesor është poshtë 10.0 m përveç në terracën e parë të lumit që rezulton të jetë 4.0-4.5 m nga sipërfaqja e tokës. Brenda kësaj shtrese qarkullojnë ujëra të shumta nentokesor, për vetë faktin se ajo paraqitet pa lidhje kohezionale. Kjo shtrese mbulohet nga suargjila deluviale me filtrueshmeri të ulët.


Shtresa e suargjilës që mbulojnë shkëmbinjte rrenjesor kanë një filtrueshmeri shumë të ulët dhe pikërisht ato që pengojnë ujërat e shiut si dhe sipërfaqësor që të deportojnë në shkëmbinjte rrenjesor. Shtresa e suargjilës ka një filtrueshmeri shumë të ulët dhe praktikisht nuk lejojnë ujërat nentokesor të qarkullojnë në drejtim të shkëmbinjve rrenjesorë.



*Fig. 10 Harta hidrogeologjike e rajonit ne studim*

Parametrat hidraulik te dherave ndryshojne nga nje sektor ne tjetrin per shkak te ndryshimeve te medha ne trashesine dhe menyren e formimit te tyre, por edhe te ndryshimeve te perberjes granulometrike dhe litologjike si ne drejtingjeresor dhe ne ate gjatesor. Ne prodhimet deluviale dhe aluviale pervec ujerave nentokesore te trajtuar me larte ne rajonin e studiuar takohen ujerat e varura me karakter zonal qe formohen ne ndershtresat e rerave brenda suargjilave. Ndersa grupi i shkembinjve te Neogjenit ka nje filtrueshmeri mjaft te ulet. Kjo vjen per vete faktin e ndertimit te tyre nga shtresa argjilo-alevrolitore. Mineralizimi i pergjithshem i tyre luhatet nga 322 mg/l deri ne 500-600 mg/l. Ne lidhje me perberjen kimike, uji eshte i tipit  $\text{HCO}_3\text{-Ca-Mg}$ .

Ne zonen e studimit dallohen disa komplekse ujembajtes sic jane ujembledhesi i Gjokajt (ne distance 728 m nga objekti), perroi i Zejces, perroi i limuthit, ujembledhesi i Bexullit, perroi i Mazrekut te cilet perfundojne ne lumin e Tiranes, i cili me pas derdhet ne lumin e Gjoles dhe si rrjedhim ne lumin e Ishmit si lumi kryesor i zones.



*Fig 11 Pamje e rajonit te zones ne studim*

### **3.10 Cilesia e mjedisit**

#### **3.10.1 Cilesia e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore**


Shqiperia zoteron burime te bollshme te ujit. Edhe pse sasite jane te mjaftueshme per nevojat aktuale, cilesia e tyre shpesh eshte problem per shkak te ndotjes se tanishme dhe historike, sidomos ne zonat e uleta fushore ku jeton pjesa me e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohen pjesa me e madhe e aktiviteteve industriale dhe bujqesore. Problem tjetër mbetet shperndarja jo e njetrajtshme e burimeve ujore ne vend. Burimet e pergjithshme, te ripërteritshme, te ujit ne Shqiperi perdoren per qellime urbane, industriale dhe bujqesore si edhe per sigurimin e prodhimit te energjise elektrike nga hidrocentralet.

Ujrat siperfaqesore dhe ato nentokesore jane te lidhur dhe varen nga njeri tjetri, por konsiderohen burime te ndara. Shqiperia ka gjashte lumenj te medhenj, ka liqene te medha nderkufitare dhe te lundrueshme, si dhe formacione te rendesishme ujembajtese, megjithate burimet ujore jane te shperndara ne menyre jo te barabarte ne vend. Ne vend ka hidrocentrale dhe rezervuare vaditjeje si dhe nje numer lagunash dhe moçalesh me vlere. Shqiperia renditet midis vendeve qe kane potenciale te medha me uje, baras me  $8600 \text{ m}^3$  per fryme ne vit.

Derdhja mesatare vjetore e ujit ne det eshte 40,5 bilion  $m^3$ , e cila korrespondon me nje derdhje prej  $1300m^3$ /sek. Reshjet jane nje burim i rendesishem i ujit me nje mesatare aktuale vjetore prej 1485 mm/vit. Burimet e ujerave siperfaqesor perdoren per prodhimin e energjise (hidro-energja), industri dhe vaditje ku formacionet ujembajtese jane shume produktive dhe furnizojne me uje te pijshem shumicen e popullsisë urbane.

Uji perdoret ne te gjitha aspektet e jetes dhe eshte i rendesishem per perdoruesit publik dhe industriale. Si rrjedhoje e sistemeve te papershtatshme te monitorimit, ndryshimet e shpejta ne aktivitetet ekonomike dhe popullsi eshte e veshtire te vleresohet perdorimi i ujit ne terma te sakte.

**Pellgu i lumit Erzen**, shtrihet nga zonat malore ne lindje dhe ne jug te Tiranës deri ne kodrat perendimore dhe fushore pergjate bregut te Adriatikut, midis Tiranës dhe Durrësit. Lumi Erzen derdhet ne detin Adriatik ne Gjirin e Lalzit prane Durrësit. Ai ka nje siperfaqe prej rreth  $760 km^2$ , me nje gjatesi te pergjithshme te linjes kryesore rreth 110 km dhe nje lartesi mesatare te pellgut ne rreth 440 m mbi nivelin e detit. Erzeni, se bashku me lumin Ishem, perbejne basenin uJOR Ishem-Erzen me nje siperfaqe  $2200 km^2$ .



*Figura 12. Harta e basenit Ishem-Erzeni*

Ne basenin Ishem-Erzen paraqitet nje situatë e ndryshme nga stacioni ne stacion per sa I perket sasise se Oksigjenit te Tretur. Stacionet reference, ura e Brarit (T1) dhe Lanabregasi (L1) jane me te pasur me oksigjen dhe varion nga 8.2 -8.6 mg/l. Ka nje sasi te paket te oksigjenit ne stacionin L2 (ish dogana) ku lumi i Lanes paraqitet ne gjendje te varfer ose cilesi eIV, si pasojë e shkarkimeve

urbane te qytetit te Tiranes. Ne tre stacionet e lumit Ishem vlera e oksigjenit te tretur eshte pothuajse konstante nga 5.6-5.9 mg/l dhe klasifikohen te cilesise setrete, gjendje e moderuar.

Zona ne pikpamje te infiltrueshmerise karakterizohet nga grupime shkembinjsh dhe dherash:

- zhavorre proluviale
- suargjila deluviale
- shkembinjte argjilo-alevrolitiko-ranore te Neogjenit (N3/1t)

Nga vrojtimet te kryera nga shpimet eshte konstatuar se niveli i ujerave nentokesor eshte poshte 10.0 m pervec ne tarracen e pare te lumit qe rezulton te jete 4.0-4.5 m nga siperfaqja e tokes. Kjo tarrace qe i perket zones se pare gjeologjike ndertohej nga nje shtrese zhavorro-ranore me trashesi deri ne 4 m e cila permban ujera nentokesore qe kane lidhje hidraulike me lumin e Gjoles. Brenda kesaj shtrese qarkullojne ujera te shumte nentokesor, per vete faktin se ajo paraqitet pa lidhje kohezionale. Kjo shtrese mbulohet nga suargjila deluviale me filtrueshmeri te ulet.

Shtresa e suargjiles qe mbulojne shkembinjte rrenjesor kane nje filtrueshmeri shume te ulet dhe pikerisht ato qe pengojne ujerat e shiut si dhe siperfaqesor qe te deportojne ne shkembinjte rrenjesor. Shtresa e suargjiles ka nje filtrueshmeri shume te ulet dhe praktikisht nuk lejojne ujerat nentokesor te qarkullojne ne drejtim te shkembinjve rrenjesore.




Fig 14 . Rrjeti hidrografik i zones



Parametrat hidraulik te dherave ndryshojne nga nje sektor ne tjetrin per shkak te ndryshimeve te medha ne trashesine dhe menyren e formimit te tyre, por edhe te ndryshimeve te perberjes granulometrike dhe litologjike si ne drejtingjeresor dhe ne ate gjatesor. Ne prodhimet deluviale dhe aluviale pervec ujerave nentokesore te trajtuar me larte ne rajonin e studiuar takohen ujerat e varura me karakter zonal qe formohen ne ndershtresat e rerave brenda suargjilave. Ndersa grupi i shkembinjve te Neogjenit ka nje filtrueshmeri mjaft te ulet. Kjo vjen per vete faktin e ndertimit te tyre nga shtresa argjilo-alevrolitore.


Mineralizimi i pergjithshem i tyre luhatet nga 322 mg/l deri ne 500-600 mg/l. Ne lidhje me perberjen kimike, uji eshte i tipit HCO<sub>3</sub>-Ca-Mg. Mjediset ujore me prane zones ne studim jane Lumi Terkuz i cili bashkohet me Lumin e Tiranës dhe derdhet ne lumin e Gjoles. Trupa ujore ne afersi te zones ne studim jane Lumi Terkuze, prr Parosa, Ujmb Tapiz, ujmb Qinamit

### 3.10.2 Cilesia e ajrit ne zone

Cilesia e ajrit ne ne zonen e Projektit kondicionohen, nga dy faktore: ndertimet urbane dhe emetimet nga makinat.

Ndertimet ne Tirane vazhdojne te karakterizuar nga intensitet te larte. Infrastruktura rrugore, ndertesat publike, te banimit dhe rikonstruktimi i rrjetit te kanalizimeve te gjitha natyrave jane kontribues ne cilesine e ajrit dhe pergjegjese te pluhurit ne atmosfere (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>50</sub>). Influenca e trafikut eshte edhe me e madhe se aktiviteti ndertimor ne cilesine e perkeqesuar te ajrit. Vleresimi i situatës nga pluhurat (PM<sub>10</sub>, PM<sub>2.5</sub>)

Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzierje e aerosoleve ( të ngurta ose të lëngëta ) që përfshin një diapason të gjerë në madhësi dhe kompozime kimike. PM<sub>10</sub>, PM<sub>2.5</sub> i referohet grimcave me diameter 10 dhe 2.5 micrometer ose më të vogël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO<sub>2</sub>, Nox, NH<sub>3</sub> dhe NMVOC PM emetohen nga shumë burime antropogjenike si djegia e lëndës djegëse , ndërtimet, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj. PM mund të shkaktojë dhe përkeqësojnë sëmundjet e zemrës dhe mushkrive, goditje në zemër dhe aritmi. PM mund të dëmtojë sistemin nervor qëndror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojë kancer. Një nga rezultatet e ekspozimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme.




Grafiku nr 2.: Vlerat mesatare vjetore të PM10

Në grafikun nr.8 janë dhënë vlerat mesatare vjetore të PM10 në 3 stacione monitorimi, 2 stacione në Tiranë dhe nga 1 stacion në Durrës. Siç vihet re dhe nga grafiku kemi tejkallim të vlerës kufi të BE prej  $40\mu\text{g}/\text{m}^3$  në tre stacione monitorimi në stacionin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministrisë Mjedisit në Tiranë. Të 2 stacionet janë stacione me burim ndotje trafikun ku numri i makinave që qarkullojnë në rrugët pranë stacioneve është shumë i lartë. Në stacionin e AKM në ndotjen e ajrit nga PM10 përveç shkarkimit të automjeteve ndikon edhe pluhuri i rrugëve dhe ndërtimeve. Vlera më e lartë ditore është monitoruar në muajin Prill dhe është  $142.55\mu\text{g}/\text{m}^3$  nga  $50\mu\text{g}/\text{m}^3$  që është standarti ditore i BE.

Problematike mbetet numri i ditëve që tejkallon standartin ditore të BE-së ( $50\mu\text{g}/\text{m}^3$ ) në 4 stacione: në stacionin e Tirana AKM numri i ditëve të tejkaluara nga 35 ditë të lejuara është 190%, në stacionin e Tirane MM numri i ditëve të tejkaluara është 77%. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen numri i ditëve që tejkallon standartin ditore të BE-së.

Tabela nr15.: Numri i ditëve që tejkallon standartin ditore të BE-së. Standarti i BE-së =  $50\mu\text{g}/\text{m}^3$

PM10 (ditore)	Numri I diteve te tejkaluar	Numri I diteve te lejuara
Tirana AKM	102	35
Tirane MM	62	35
Durres	ska tejkallim	35



Grafiku nr. Numri i ditëve që tejkalojnë standartin e BE

### 3.10.3 Niveli i zhurmave te zones

Udhezimi i perbashket i Ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe Ministri i Shendetsisenr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”, percakton vlerat kufi te zhurmave, sipas vlerave udhëzuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Duhet theksuar se ne afersi te zones se objektit nuk ka qendra te banuara

Tabela nr.16: Nivelet kufi te zhurmes per mjedis te caktuara

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA <sub>eq</sub> (dBA)	Koha bazë (orë)	Lamax Fast (dB)
<b>Zona me aktivitetet social-ekonomik</b>				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
<b>Mjedis urban</b>				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
Ceremoni, 51Industri dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët < 5 herë/ vit)	100	4	110

Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85# 4	1	110
Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit)  Dëmtim dëgjimit (fëmijët)	-	-	140#2  120#2
<b>Parqe publike</b>				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	#3		

Shpjegime:

Laeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.

Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.

Lamax Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën *fast* (e shpejtë)

# 1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur.

# 2 = Presioni zanor maksimal (Lamax, fast) matur 100 mm larg veshit.

